

# RELACIONI TEKNIK

OBJEKTI: ‘‘RIKONSTRUKSION I ZYRAVE EKZISTUESE’’



DHJETOR 2018

# RAPORTI TEKNIK

## **OBJEKTI : ‘Rikonstruksion zyrove ekzistuese’**

### ***1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT***

#### **1. Të Përgjithshme**

Hartimi i projektit me objekt: ‘Rikonstruksion i zyrove ekzistuese’ është bërë nga stafi i Degës Teknike sh.a Durrës bazuar në nevojat e zgjerimit të stafit të UKD. Objektet ndodhet në lagjen nr.17, rruga ‘Dalip Peza’, Durrës në ambientet e UKD-së. Zyrat ku do të kryhen rikonstruksionet janë oficina, ish magazina e mallrave hidraulik, kancelarive, dispeceria dhe laborator.



**Figura 1.** Harta me vendodhjen e objekteve

#### **2. Gjendja ekzistuese**

Godinat ku do të realizohet projekti janë të ndërtuara para dhe pas viteve 90'. Edhe pse një pjesë e tyre janë ndërtuar pas viteve 90' amortizimi është pothuajse në të njëjtën shkallë me ato të ndërtuarat në vite më të herëshme. Objekteve u janë bërë rikonstruksione të pjesshme gjatë këtyre viteve, por gjendja vazhdon të jetë problematike. Aktualisht janë 11 ambiente me zyra dhe magazina të vjetra, 1 kateshe, të cilat janë jashtë kushteve teknike. Ato kanë pësuar dëmtime dhe amortizim të shkajshëm, qoftë nga jetëgjatesia e tyre, ashtu dhe nga nderhyrjet në punimet e brendshme sipas funksioneve të përdorimit nga institucioni, që kanë patur në vite. Soleta dhe muret perimetrale kanë probleme si çarje, rënie etj., gjithashtu shfaqin probleme serioze të lageshtirës. Nje pjese e dritareve janë me tek xham dhe kanë probleme në termoizolim. Përveç amortizimit të strukturës së mureve dhe fasades së këtyre godinave, paraqiten probleme edhe në ndarjet në interiorin e tyre, duke e bërë të papershtatshëm ambientin e punës dhe të magazinimit të mallërave.

Psh. Magazina e elektrikeve, kompjuterikeve dhe kancelarive ndodhet në 4 ambiente të ndryshme, të pa organizuara në sergjene dhe jashtë kushteve teknike, për këtë arsye ndodh që një pjesë e mallërave të dalin jashtë funksioni.



Figura 2. Planimetria e ambienteve ekzistuese

**Kondicionet Urbanistike:**

SIP.GJURMË NDËRTIMI=565 m<sup>2</sup>

LARTËSIA:

Objektet 1= 2.65 m

Objektet 2= 3.05 m

Objektet 3= 4.8 m

Objektet 4= 5.5 m

Objektet 5= 6 m

NUMRI KATEVE = të gjitha objektet janë 1 katëshe



Figura 3. Foto nga gjendja ekzistuese

## II. OBJEKTIVI.


Objektivi kryesor është hartimi i projektit të rikonstruksionit të zyrave të vjetra, për të siguruar ambiente të përshtatshme pune për stafin ekzistues si dhe për stafin që do të zgjerohet, referuar Plan Buxhetit 2019, në mënyrë që të rritet dhe performanca e punës.

## III. QËLLIMI I PROJEKTIT.

Qëllimi i projektit është përmirësimi i kushteve dhe standardeve të godinave nëpërmjet rikonstruksionit, adaptimit të zyrave, hapësirave të përbashkëta si dhe restaurimit të fasadave. Është menduar që duke qënë se UKD ka të nevojshme zgjerimin e zyrave, të bëhet rikonstruksioni i tyre dhe i magazinave ekzistuese si dhe të ndryshohen funksionet dhe organizimi i tyre.

Bazuar në gjendjen ekzistuese të objektit, për realizimin e objektivave të projektit janë parashikuar të kryhen punime për të krijuar amjentet e mëposhtme:

- 1) Sektorin e Mirembajtjes
- 2) Sektorin e Kanalizimeve
- 3) Zyrën e teknikëve të laboratorit
- 4) Zyrën e mjekut
- 5) Dispecerin
- 6) GIS-in
- 7) Zyrën e Kontrollit dhe Monitorimit (SCADA)
- 8) Zyrën e Teknik Bilanci
- 9) Zyrën për Repartin Mekanik
- 10) Magazinën e mallërave elektrik, kompjuterik dhe kancelarive
- 11) Kapanonin për Repartin Mekanik








Figura 2. Planimetria e propozimit të ambienteve

**IV. VOLUMET E PUNIMEVE.**

Volumet kryesore të punimeve për rikonstruksoin e zyrave ekzistuese të UKD janë:

	<b>PUNIME PRISHJE +GËRMIMI</b>	Njësia	Sasia
1	Shkepje katrama	m <sup>2</sup>	373
2	Shkepje suva solete	m <sup>2</sup>	141
3	Shkepje suva muri	m <sup>2</sup>	541
4	Prishje solete b/a	m <sup>3</sup>	12.1
5	Prishje shtresa betoni	m <sup>3</sup>	0.6
6	Prishje mur tulle pa pastrim	m <sup>3</sup>	18.1
7	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m <sup>3</sup>	35
8	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m <sup>3</sup>	87.5
	<b>PUNIME MBUSHJE</b>		
9	Hedhje,rrafshim,mbushje dheu me krahë,kategoria e III	m <sup>3</sup>	4
10	Nënshtresë zhavori	m <sup>3</sup>	28
11	Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20cm, përhapur ngj.mak.	m <sup>2</sup>	15.5
12	Cilindrim shtrese çakelli t=15cm, me rul	m <sup>2</sup>	72
	<b>PUNIME NDËRTIMI</b>		
13	Ndërtim mur tulle me vrima 6 t=12cm	m <sup>3</sup>	31.1
14	Ndërtim mur tulle plote h-3m, me llaç perzier M 25	m <sup>3</sup>	21

15	Suvatim solete h~ 4m me drejtues, me krahe	m <sup>2</sup>	211
16	Suvatim muri	m <sup>2</sup>	1206
17	Suvatim trare e kollona	m <sup>2</sup>	9
18	Suvatim me grafiato h> 4m	m <sup>2</sup>	46
<b>PUNIME BETONI</b>			
19	Brez b/a C16/20, h~8m	m <sup>3</sup>	11
20	Shtrese betoni C7/10	m <sup>3</sup>	20.5
21	Shtrese betoni C16/20	m <sup>3</sup>	33
22	Shtrese betoni C 16/20, per bazament tornoje	m <sup>3</sup>	0.5
23	Tra themeli b/a C 16/20	m <sup>3</sup>	5.3
24	Soleta të plota b/a C 20/25 t=10 cm, h~4 m	m <sup>3</sup>	11
25	Kollona b/a monolite C - 16/20, h ~ 4 m	m <sup>3</sup>	0.6
26	Beton M-200 për plinta	m <sup>3</sup>	1.75
27	Shtrese betoni C 16/15, per trotuar	m <sup>3</sup>	2.4
28	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresa k katrama	m <sup>2</sup>	532

#### V. KONKLUZIONE.

Në përfundim të projektit konkludojmë si më poshtë:

Projekti do të realizohet në një fazë.

Preventivat e zbatimit janë vlerësuar sipas VKM. Nr.629 date 15.07.2015.

Në preventiv është përfshirë Fondi rezerve 5% dhe dhe 20% T.V.SH

Analizat e çmimeve sipas normativave të tregut.

#### PROJEKTUES

Ing.hidro.Gerald DAUTAJ

Ing.hidro.Lorenc FACJA

Ing.ndertimi Artor KOCILIA

Ing.hidro Qamile QEHAJAJ

Ark. Mirela HASANBASHAJ